



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E SHËNDETËSE DHE MBROJTJES SOCIALE**  
**DREJTORIA E SPITALIT“IHSAN ÇABEJ ,, LUSHNJE**  
**DREJTORIA**

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Lushnje me \_\_\_\_\_ 2023

**MIRATOI**  
**DREJTOR**  
**Laureta Xhafa**

**PROCES VERBAL**

**Per hartimin e dokumentave te tenderit me objekt:**

**“Blerje material mjekimi”– Blerje materiale mjekimi per nevoja spitalore.**

**Procedure “E Hapur e thjeshtuar” Marreveshje kuader me nje operatore ekonomik**

Mbeshtetur ne Urdherin e prokurimit Nr **723 prot. date 18.05.2023** te nxjere nga Titullari i AK u mblodh njesia e prokurimit per hartimin e dokumentacionit te tenderit me objekt **“Blerje Materiale mjekimi** me vlerë 7 358 700 (shtatë milion e treqind e pesëdhjetë e tetë mijë e shtatëqind) lekë pa TVSH.

***Komisioni i caktuar per argumentimin e fondit limit, hartoi proces-verbalin e fondit limit i cili eshte bashkelidhur.***

U be llogaritja e diteve mbeshtetur ne Ligjin nr 162/2020 “Per prokurimin Publik”(I ndryshuar), u vendos data e dergimit te ftesave per oferte ne rruge elektronike dhe data e hapjes se ofertave do te jete data 12.06..2023

- Vendi ku do te dorezohen ofertat u vendos te jete adresa: [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

**1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT**

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);

- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë në lidhje me veprimtarinë profesionale;
- dh) Operatori Ekonomik nuk ka pagesa pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) Operatori Ekonomik ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) Operatori Ekonomik nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) Operatori Ekonomik ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) Operatori Ekonomik ka paraqitur një Ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) Operatori Ekonomik kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të përfutur fonde publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentet e gjuhës së huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i noterizuar në shqip.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

### **Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.**

**Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.**

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

## 2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

### 1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;*

### 2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

#### 1.2 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

**Sipas kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit të shtojcës 7**

2.2.1 Xhiroja vjetore minimale e **të paktën njërit prej tre viteve te fundit financiare** të jetë jo më e vogël se 40% e vleres së përlllogaritur të fondit .

#### 2.3Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit **nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës**, në një vlerë jo më të vogël **se 40%** e e vleres së përlllogaritur të fondit

– Si dëshmi për përvojën e mëparshme me nje ent publik, kërkohen **vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratëndhe fatura tatimore të shitjes ku të evidentohen artikujt.**

– Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm **fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore\*\***, ku shënohen datat, shumat dhe sasisë e mallrave të furnizuara.

*Faturat të jenë të deklaruara në organet tatimore, në përputhje me parashikimet e nenit 40, pika 4, të VKM nr.285, datë 19.05.2021*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të vetëdeklarojë origjinën e mallit dhe kompaninë prodhuese. Te plotesohet ne Shtojcën 2. Lista e Çmimeve të artikujve të DST.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikatë ISO 9001:2015/ose/ ekuivalent ISO 13485 "Per Sistemin e menaxhimin te cilesise" /ose ekuivalent/ të vlefshme, për prodhuesit e artikujve të ofruar.ose në rastin kur OE ofertues nuk është prodhues të paraqesë Vetëdeklarim ku të deklarojë se furnizuesi është konform Standardeve të Cilësisë.

*Vetëdeklarimi do të verifikohet në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, dhe në rastin e shpalljes fitues, OE do të dorëzojë Certifikatën në fjalë. Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

2.3.4 Ofertuesi duhet të jete i certifikuar me ISO 9001:2015 ose ekuivalente per import , eksport , tregetim te materialeve mjekesore /ose ekuivalent/ Per kete ai duhet te paraqese certifikaten certifikaten perkatese , te vlefshme.

*Certifikata te jetë leshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certifikata konformiteti CE ose CE sipas direktivës (MDD ose MDR) 93/42 EEC, të vlefshme,ose Certifikate FDA, ose ekuivalent, për artikujt e ofruar, sipas kategorizimit të tyre.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për pjesemarrje ne tender , për tregëtimin e artikujve të ofruar per periudhen e hapjes se procedures objekti i prokurimit.

*Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës.*

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë Autorizim per tregtim te pajisjeve mjekesore të vlefshëm të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sipas Ligjit 89/2014 "Per pajisjet mjekesore" (e vlefshme vetem per OE lokalë/vendas)

2.3.8 Kërkohen të paraqiten katalogë teknikë për të gjithë artikujt e ofruar. Në katalogë, artikujt dhe specifikimet teknike të tyre duhet të markohen me ngjyrë të ndezur sipas numrit rendor të përcaktuar në formularin e ofertës. (Katalogët duhet të ngarkohen në [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al) së bashku me dokumentacionin e kërkuar në këto DT.

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit "Ihsan Cabej" Lushnje, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: "Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave të kësaj procedure prokurimi dhe jo para datës **12.06. 2023 ora 10:00**

- Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

- Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës .

#### o CERTIFIKATAT E CILËSISË

- Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë certifikatat e kërkuara të cilësisë sipas zërave që merr përsipër të realizojë në akt marrëveshje.

Shënim: KVO rezervon të drejtën e verifikimit të të dhënave të paraqitura nga ofertuesit

**Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.**

**Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim**